



*Xucan!*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.12, datë 28.01.2026

**“PËR MIRATIMIN NË PARIM TË BASHKËFINANCIMIT NË MASËN 30% TË VLERËS TOTALE TË PREVENTIVIT NË PROGRAMIN E PËRMIRËSIMIT TË KUSHTEVE TË BANIMIT TË BANESAVE EKZISTUESE”.**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 28.01.2026, mori në shqyrtim projektaktin e bështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.22/2018 “Për strehimin Social”, VKM nr.454, datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, VKM nr.458, datë 03.07.2019, VKM nr.823, datë 18.12.2019, VKM nr.301, datë 15.04.2020, VKM nr.579, datë 22.07.2020, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.33, datë 26.08.2020, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.31, datë 18.11.2019, Strategjia e Strehimit Social 2016-2025, miratuar me VKM nr.405, datë 01.06.2016;

**VENDOSI:**

Të miratoj në parim, bashkëfinancimin në masën 30% të vlerës totale të preventivit, në programin e përmirësimit të kushteve të banimit të banesave ekzistuese.

Vendimi u miratua me 12 Vota pro, vota kundër - s’ka , abstenim – s’ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

**KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**

**Elsa PETRITAJ**

